

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR
"Rezus Negativ" Sh.p.k

Sot më datë , **26/ TETOR / 2022** , në Njesia Administrative nr. 14 Rr. Rruga "Aleksandri i madh", Pallati Mesaplik-05,shkalla B, kati 1 biznes, dyqani nr 13 Tirane , është i pranishëm përsonealisht Ortaku:

Ervin Lazi, i biri i Reshat-it, lindur më 06.02.1981, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I10206138V, banues në Rr. Rruga Ali Pashë Gucia, Yrshek, Tiranë, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

Ortaku i shoqërisë në themelim deklaron me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, pranimin e dispozitave dhe parashikimeve që vijojnë, hartimin e Statutit të shoqërisë së re të së drejtës shqiptare **"Rezus negativ" Sh.p.k** mbi bazën e ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar dhe hartojnë këtë Statut si vijon:

Neni 1 Emërtimi i Shoqërisë

Emri i shoqërisë është **"Rezus negativ" Sh.p.k.** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin **"Rezus negativ" Sh.p.k** (në vijim "Shoqëria").

Neni 2 Selia

Njesia Administrative nr.14, Rr. Rruga "Aleksandri i madh", Pallati mesaplik-05, shkalla B, kati 1 biznes, dyqani nr 13, Tirane

Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë, si dhe mund të vendosë hapjen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit dhe është pa afat të caktuar.

Shoqëria e fiton përsonealitetin juridik nga momenti regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë.



Neni 4 Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

Shoqëria ka për objekt Marketing Online, Marketing me anë të promocioneve në terren; Marketing me dizenjim. Marketing në rrjete sociale. Dizenjim dhe printim Kartëvizita. Dizenjim dhe printim fletë palosje për promocione të ndryshme. Dizenjim dhe printim të logove. Dizenjim dhe printim të uniformave. Dizenjim dhe printim për adeziv për fasada. Ndërtim dhe mirëmbajtje për Website. Urë lidhëse dhe ndërmjetësim për shitblerje për mallra të ndryshme. Urë lidhëse nëpërmjet koordinatave nëpërmjet koordinatave satelitore në hartë dixhitale për dhënie me qera dhe/ose shitje të pasurive të paluajtshme. Urë lidhëse nëpërmjet koordinatave satelitore në hartë dixhitale për shit-blerje për automjete dhe pasuri të paluajtshme. Urë lidhëse për individë me adresë elektronike në Google Maps. Konsulencë marketingu. Shitblerje online me platformë elektronike. Njoftime punësimi, njoftime sensibilizuese, njoftime të ndryshme për evenete publike. Promovim ide Inovatore. Marketing global. Motorr kërkimi adresash. Promovim i turizmit. Promovim i kulturës. Adresa dixhitale etj.

Neni 5 Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 1000 (njëqind) Lekë. Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (një) kuotë e cila zotërohet nga Ortaku :

- **Ervin Lazi**, i biri i Reshat-it, lindur më 06.02.1981, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I10206138V, banues në Rr. Ruga Ali Pashë Gucia, Yrshek, Tiranë, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

Kapitali fillestare i Shoqërisë mund të rritet dhe është totalisht i paguar dhe nënshkruar nga ortakët.

5.2 Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestare, nga pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme dhe nga pasuri të tjera të dhëna ose që do të jepen të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.

5.3 Kuotat e kapitalit derdhen nga ortakët në Bankë, ne llogarine bankare të Shoqërisë dhe derdhjet e kuotave regjistrohen në librin e llogarisë së Shoqërisë.


5.4 Të gjitha pjesët e kapita lit themeltar janë të nënshkruara nga ortakët e Shoqërisë.

5.5 Ortakët kanë të drejtë të tërheqin fondet e depozituara si kapital themeltar të Shoqërisë, ne rast se Shoqëria nuk regjistrohet ne Qëndrën Kombëtare të Biznesit, brenda 6 (gjashtë) muaj nga data e depozitimit të fondeve.

Neni 6 Transferimi i kuotave me akt midis të gjallëve dhe me trashëgimi

6.1 Transferimi i kuotave është i vlefshëm si me akt midis të gjallëve si dhe me trashëgimi ndaj ortakëve të Shoqërisë, vetëm ne rast se rezulton se janë respektuar dispozitat e këtij neni.

6.2 Në rast transferimi të kuotave midis të gjallëve me akt, ortakëve i takon e drejta e parablerjes. Ortaku transferues më parë duhet të bëjë një ofertë, ortakëve të tjerë me letër-rekomande, ku përcakton cmimin e kërkuar për shitjen e kuotave të tij. Në ketë rast secili nga ortakët në proporcione pjesëmarrjen në kapitalin themeltar ka të drejtën e parablerjes.



6.3 Në rast mosmarrëveshjesh mbi cmimin e kërkuar, ky i fundit do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i cili miratohet me shumicë të thjeshtë nga asambleja e ortakëve i cili do të përcaktoje cmimin e shitjes duke u bazuar mbi vlerën reale të kuotave.

6.4 Në rast mosmarrëveshjeje mbi emërimin e ekspertit kontabël, ky i fundit me shpenzimet e secilës palë, do të zgjidhet nga gjykata ku ka selinë shoqëria dhe me kërkesë të palës së intëresuar.

6.5 Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kritereve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

6.6 Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, shitësi por edhe blerësi kanë të drejtë të tërhiqen, përkatesisht nga shitja dhe blerja dhe shpenzimet e ekspertit do të janë në ngarkim të personit që tërhiqet.

6.7 E drejta e parablerjes që nuk është ushtruar nga ana e njërit prej ortakëve i kalon ortakëve të tjerë, gjithmonë në përputhje me pjesët e tyre në kapitalin themeltar.

6.8 Ortaku shitës i kuotave duhet t'i transferojë këto të fundit me akt të shkruar ortakëve blerës brenda 3 muajve nga marrja e komunikimit dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël brenda afatit prej 60 ditë nga dita e vlerësimit.

6.9 E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet brenda një periudhe tre mujore nga data e komunikimit të ofertës ose brenda 60 ditëve nga data e fiksimit të cmimit nga ana e ekspertit kontabël që është emëruar. Pasi kanë kaluar afatët e mësipërme, shitësi ka të drejtën t'i transferojë tëk të tretët kuotat e tij.

6.10 Transferimi i kuotave për shkak trashëgimie ndaj trashëgimtarëve të të ndjerit është i kufizuar me dhëni e miratimit e ortakëve të mbledhur në asamblenë e përgjithshme. Në rast kundërshtimi të ortakëve për transferimin e kuotave drejt trashëgimtarëve të të ndjerit, cmimi i shitjes do të caktohet sipas procedurave për transferimin me akt midis të gjallëve si me sipër.

Neni 7

Fitimet e Shoqërisë i takojne ortakeve të saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.

Neni 8


Shoqëria do të përdorë dhe disponojë pasurine e saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, matëriale ose jo-matëriale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së vet të akumuluar, tëk të tjerët.

Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria gezon të drejta sikundër cdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Shoqëria, vepron në regjin e pronës privatë dhe merr përsipër të drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar ne të.

Neni 10 Drejtimi i Shoqërisë



Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e ortakëve, të mbledhur në asamble të përgjithshme, të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuara në këtë statut. Ndërsa këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi në aktin e themelimit dhe ne statut;
2. miratimi i buxhetit vjetor, të veprimtarise së dministrimit, të inventarit, të bilancit të llogarisë vjetore;
3. emërimi e shkarkimi i administratorëve qofshin ortakë ose jo dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht motivi;
4. miratimin e kredive dhe të garancive;
5. miratimi i tarifave për shërbimet qe kryen shoqëria;
6. përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së shoqërisë;
7. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
8. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
10. vendimin lidhur me kriimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësimeve ose të agjencive të Shoqërisë;
11. vendimin për riorganizimin dhe mbylljen e Shoqërisë;
12. vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ligjore në të cilën është e përfshirë Shoqëria;
13. vendimin për emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar apo të konsulentëve të tjere, qoftë persona fizike qoftë juridike;
14. vendimin për ndarjen e kuotave dhe për anullimin tyre;
15. vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave të procedurës për mbledhjen e asamblesë;
16. vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të Shoqërisë;
17. vendimin në shitjet e kuotave të Shoqërisë;
18. vendimin për cështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
19. marrjen e cdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

Neni 11

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose sipas zgjedhjes së administratorit nëpërmjet postës elektronike. Adresa elektronike email e ortakëve regjistrohet në dokumentet e Shoqërisë.

Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit për thirrje.

Neni 12

Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Pjesëmarrja apo votimi në asamblenë e përgjithshme, mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Në këto

raste është e nevojshme prania e Noterit. Procesverball i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.

Asambleja e përgjithshme mund të mblidhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do t'i nënshtronen procedurave të parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri.

Kuorumi i nevojshëm për të vodosur në asamblenë e zakonshme dhe/ose Jashtëzakonshme është ai i parashikuar ne nenet 86, 87 të ligjit 9901 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 13

Administratori i parë dhe i vetëm i shoqërisë është:

Ermal Çuni, i biri i Perikli-ut dhe i Vase-s, lindur më 05.04.1981, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I10405150L, banues në Lagjia "Qemal Stafa", Rruga "Astrit Bezhani" Pallati 89, Hyrja nr 2, Apartamenti nr 10, Elbasan, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

Administratori i vetëm emërohet për një afat 5 (pesë) vjetar duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtë riemërimi në qoftë se do të emërohet sërisht administrator nga asambleja e ortakëve.


Asambleja e përgjithshme mund të vodosë për shkarkimin e tij. Administratori ka të drejtë të jepë dorëheqjen e parakohshme, përpala mbarimit të mandatit, me njoftim, dhënie llogarie dhe aprovim përpala asamblesë së përgjithshme, sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme mund të emërojë edhe më shumë se një administrator, të cfarëdo kombësie dhe të jashtëm për shoqërinë. Në rastin e emërimit të një apo më shumë administratorëve në fuqi, secili nga administratorët mund të ushtrojë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmës ashtu si rezultojnë në aktin e emërimit të tyre. Secili nga ato do të jetë individualisht përgiegjës për përbushjen e funksioneve të dhëna nga ligji për administratorin dhe do t'i komunikojë të tjerëve ose administratorit tjetër veprimet nga ai të kryera. Administratori ose administratorët kanë detyrimin të japid llogari përpala asamblesë së përgjithshme të ortakëve, për aktivitetin e tyre, cdo herë që i kërkohet nga ortakët.

Neni 14

Administratori i vetëm kryen detyrat e përcaktuara nga ortaket e Shoqërisë ne ketë statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të rregulluara me ligj. Ndërsa këto përshtihen detyrat e listuara me poshtë.

1. Të veproje dhe të nënshkruaje ne emër të shoqërisë.
2. Të hartoje rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe një plan biznesi për vitin finanziar, që do të miratohet ne asamblenë e përgjithshme.
3. Të marre vendime lidhur me kreditë që do të merren dhe dhënien e garancive.



- Të përpunoje dhe të paraqesë për miratim ne asamblenë e përgjithshme raportë për ecurinë e aktivitetit të shoqërisë dhe të bilancit të mbylljes se aktivitetit financiar të vitit paraardhës, sipas asaj që parashikohet në ligj.
- Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme.
- Administratori (apo administratorët në rast se do të emërohet ndonjë tjetër në vijim) është përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit apo të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ecurisë se aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar.
- Të kryeje të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
- Të përfaqësoje shoqërinë tregtare.
- Të kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë me korrekësni dhe saktësi.
- Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet ne ligjin për Qëndrën Kombëtare të Biznesit.
- Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë.
- Pranimet në punë, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna pasi të jetë marrë më parë aprovimi nga asambleja e ortakëve.
- Të emërojë financier e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht indikatorët financiarë tre-mujorë, gajshtë-mujorë dhe vjetorë, për aktivitetin e kryer të Shoqërisë.
- Të mirë administrojë Shoqërinë.
- Të lidhë marrëveshje me të tretë ne kufijtë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët.
- Të zbatojë rregulloren e brendshme të Shoqërisë.
- Të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara Shoqërisë nga veprimet e tij.
- Të shpërblehet për punën qe kryen sipas marrëveshjes me ortakët themelues.
- Të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson si të rëndësishme për shoqërinë.
- Të kryejë të gjitha veprimet bankare në lidhje me llogarinë e shoqërisë.
- Administratori ka të drejtë dhe detyrë të thërrasë asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitive të përcaktuara ne nenet 11 dhe 12 të këtij statuti dhe të ligjtit aty ku nuk parashikohet shprehimisht në statut.

Neni 15 Të drejtat e Shoqërisë

Shoqëria ka të drejtë:

- të kryejë veprimitari në baze të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimitarisë;
- të sigurojë pasurinë e vet;
- të marrë kredi në lekë dhe në valutë nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;
- të përfitojë nga favoret që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera;
- të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
- të punësojë punëtorë, vendas ose të huaj;

7. tē eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

Neni 16 Detyrat e Shoqërisë

Shoqëria ka për detyrë:

1. tē sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
2. tē japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
3. tē sigurojë punonjësit e saj;
4. tē plotësoje detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
5. tē pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkoen nga ligji, për tē zbatuar objektin e veprimtarisë së saj;
6. tē respektojë standardet si dhe tē gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

Neni 17 Marrëdhëniet ekonomike – financiare të Shoqërisë

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë se saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

Neni 18

Në selinë e Shoqërisë mbahet dokumentacioni finanziar, në bazë të tē cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë.

Neni 19

Viti finanziar fillon çdo vit më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor tē tē njëjtit vit.

Neni 20

Shoqëria mban llogarinë e saj në Bankë. Llogaritë mbahen në LEKE dhe/ose EURO dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatës.

Neni 21

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit finanziar, Shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve tē vitit të mëparshëm, le mënjanë 5% tē fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme", derisa ky fond tē arrijë masën 10% tē kapitalit themeltar.

Neni 22 Dispozita tē veçanta

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa tē zakonshme, tē realizuar sipas parashikimeve tē ligjit ne fuqi dhe mund tē ketë një markë tē vetën. Në rast tē krijimit tē një faqe interneti, mund tē deklarohet në mënyrë vullnetare në QKB.

Neni 23 Shndërrimi

Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri tē tipeve tē tjera, mund tē bëhet me vendim tē ortakëve themelues sipas mënyrave tē parashikuara në ligj.

Neni 24 Prishja e Shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë, mund tē vijë për shkaqet e parashikuara në nenin 99-të ligjit nr. 9903 datë 14.04.2008 dhe për arsyet si më poshtë:

- me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- me vendim të gjykatës;
- humbja e kapitalit të Shoqërisë;

Në këto raste, ortakët e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë se Shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizikë e juridikë, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

Në rast se fondet e disponueshëm, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të Shoqërisë që të derdhe tërësisht kuotat që u takojnë.

Neni 25 Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni

Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakëve të Shoqërisë, midis ortakëve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe Administratorit do t'i nënshtrohen për zgjdhje gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare ne fuqi.

Neni 26

Ky statut përpilohet ne 2 (dy) ekzemplarë në gjuhën shqipe , të nënshkruara rregullisht nga Ortaku.

Ngarkohet administratori i shoqeris Z. Ermal Çuni, lindur më 05.04.1981, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I10405150L, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, per te kryer te gjitha procedurat prane QKB-se per regjistrimin e shoqeris

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË

"Rezus Negativ" Sh.p.k

ERVIN LUZI



Tiranë më 26 / TETOR / 2022